

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR" FLAMURI 25"

KREU I
FORMIMI I SHOQERISE

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**FLAMURI 25**" shpk. Themelohet ne perputhje me Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008" Per shoqerite tregtare Per rregjistrimin ne rregjistrin tregtar ".

QENDRA E SHOQERISE

Kjo shoqeri krijohet me ortak te vetem .

Ajo e ka seline e saj ne Otlak Berat.

Shoqeria "**FLAMURI 25**" shpk, ka te drejte te hape filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj. Administrator e kesaj shoqerie eshte Z. Gledis Flamuri.

NENI 2

Shoqeria "**FLAMURI 25**" shpk.e zhvillon veprimtarine saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi .

Shoqeria "**FLAMURI 25**" shpk, eshte person juridik. Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e rregjistrimit ne Q.K.B.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

NENI 3

Shoqeria "**FLAMURI 25**" shpk, krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj me afat te papercaktuar dhe Administrator 5 vjet.

Shoqeria "**FLAMURI 25**" shpk, mund te zgjase afatin e veprimtarise se saj ose te mbylle aktivitetin e saj para ketij afati sipas dispozitave qe percaktohen ne kete Statut dhe sipas kriterave qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi .



NENI 4

Shoqeria FLAMURI 25 "shpk, per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretit pergjigjet vetem me pasurine e saj

Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk e pengon ortakun e vetem te kete pavaresi ligjore , organizative dhe te drejta pronsie jashte kesaj shoqerie .

OBJETI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI. 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise "FLAMURI 25" shpk, do te kete si objekt te aktivitetit te saj :

- Importe perpunim (mbushje) dhe eksporte ne origjine te ullirit .
- Te lidhe aktmarreveshje me shoqeri te tjera te vendit dhe te huaj.

Kapitali themeltar, 100.000(njeqinde mije)leke, ai eshte I ndare nje(1) kuot, te vleres se kapitalit themeltar, Gledis Flamuri 100/% .

Administrator I shoqerie Z.Gledis Flamuri

Selia ne Otllak Berat.

Afati i veprimtarise do te jete i pa kufizuar dhe Administratori 5 vjet.

Shoqeria eshte pronare , perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.

Shoqeria mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale , perfshir te drejten per te afruar pasurite e saj dhe per te marre kredi bankare .

KAPITULLI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar, 100.000(njeqinde mije)leke, ai eshte I ndare nje kuot, te vleres se kapitalit themeltar, Gledis Flamuri 100%

Kapitali themeltar ose pjese te caktuar te tij jane te transferueshme perkundrejt personave te trete .

Transferimi I kapitalit ne favor te nji personi te drete behet gjithmon me akt noterial.Te gjitha veprimet e shoqerise me kapitalin themeltar behen me miratimin e ortakut te vetem qe do te thote se shoqeria mund edhe ta shtoje ose pakesoje kapitalin e saj sipas vendimit te ortakeve



NENI 7

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen ne nje rregjister te vecante te ruajtur prane selise se shoqerise te quajtur regjistri I Shoqerise.

NENI 8

Fitimi neto I realizuar nga aktiviteti I shoqerise do te disponohet nga ortaku i vetem.

Po keshtu transferimi i kuotave ne rruge trashegimie behet sipas neneve 73,74,75 te ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per shoqerit Tregtare .

Te gjitha transferimet kane efekt mbi shoqerine qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Asambles se Pergjithshme . Kuotat prej 1 leke jane te pandashme .

Organet e shoqerise jane :

- 1.- Asambleja e Pergjithshme
- 2.- Administratori

NENI 9

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj .

Bilanci i aktivitetit te shoqerise duhet te perfundoje brenda muajit dhjetor te çdo viti .

Bilanci i aktivitetit financiar mund te behet nga vete ortaket ose nga eksperte te caktuar prej tij .

NENI 10

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvilimin e zgjerimin e aktivitetit te saj ne perputhje me rregullat e legjislacionin shqiptar ne fuqi

Perberja e fondeve , burimeve financiare te tyre caktohen nga ortaku i vetem .

NENI 11

Shoqeria i disponon plotesisht mjetet e saj financiare .



TE DREJTAT DHE KOPETENCAT E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

NENI 12

Ortaku i vetem ka tre te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra prej tij si :

-Te marre pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomike – tregtare te shoqerise ne perputhje me statutin .

-Te kerkoje dhe t!l jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria (bilanci ,libra ,llogarie).

-Te mbylle shoqerine kur e cmon te arsyeshme prej tij duke caktuar dhe eksperte kur cmohet e aresyshme prej tyre.

NENI 13

-Te zbatoje kriteret e caktuara nga ligji ne fuqi per puntoret dhe nepunesit qe punesohen ne shoqeri .

KREU IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQERISE

NENI 14

Asambleja e Pergjithshme ka kopetencat e meposhtme ,

- Percaktimi politikave tragtare te shoqerise
- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut
- Ajo emeron administratoret , zevendesim, ekspert dhe revizoret kontabel.
- Ajo aprovon cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marrveshje lihet ne kompetencat te saj .
- Ajo mund te shfuqizojte ndalimin e konkurrences (Ligji 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerit tregtare “ , neni 17 pika 1) nepermjet nje autorizimi te posacem .
- Percakton shperblimin per administratoret, ekspertet , revizoret kontabel .
- Ben transferimin e kuotave te te treteve



- Bene lidhje e kontratave per dhenie dhe marrjen te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontratat ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme .
- Realizon blerje , shitje si dhe tjetersim te pasurive te paluatshme te shoqerise etj .
- Ka te drejte te beje modifikimin e kontrates se shoqerise .

ADMINISTRIMI

NENI 15

Shoqeria ka te gjitha kompetencat qe te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise ne mardhenie me personat e trete ,kur gjate veprimtarise se tyre shkelin ligjin , statutin ose per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise .

Ne rast se ortakët nuk deshirojne te kryeje kete funksion , ai merr vendim per emerimin per nji afat prej tre vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem .

PJESMARRJA NE VENDIME

NENI 16

Ne rast te emerimit te nje administratori jo ortak , ai ne mardhenje me ortakun dhe te trete ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakut .

MARRDHENIET E PUNES

NENI 17

Mardhenjet e punes me punetoret qe do te punesohen prane shoqerise "**FLAMURI 25**" shpk, rregullohen me kontrate individuale, qe do te lidhet me secilin prej tyre .



Shoqeria merr pesiper te derdhe rregullisht te gjitha detyrimet gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesureve te saj ne organet kompetente perkatese sipas ligjit .

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

NENI 18

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit dhe Asambles se Perghithshme, si dhe gjithe aktiviteti i shoqerise, i besohet nje ekspert ose revizori kontabel .

Ky ekspert do te qendroj ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe munde te rizgjidhet .

Asambleja cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore .

BILANCI DHE FITIMI

NENI 19

Bilanci i shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti ku i pari do te jete 31 Dhjetor 2025 Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finaciar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku , miratohen nga ortaku i vetem .

Miratimi i dekumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nji afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes si vitet finaciar .

NENI 19

Pas miratimit te llogarise vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimeve, qe perbehet nga fitimi i vitit finaciar , te cilit i jane zbritur shumat e lena per fondin reserve te domosdoshem te percaktuar nga ortaku si dhe te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme si dhe jane zbritur ose jane shtuar perkatesisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme, ortaku i vetem percakton edhe dividendet e realizuar mbi fitimin .

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 19



Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne statut , ne qoftese ortakut i vrtem me vullnetin e tij te lire nuk e zgjasin kete afat.

Ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit te parashikuar ne Statut kur per kete merr vendim ortakut i vetem.

Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortakut vendos shnderrimin e shoqerise nga shpk, ne nji lloj tjeter shoqerie .

NENI 20

Kur shoqeria likujdohet plotesisht, ortakut krijojn komisionin e likujdimit me ekspertet perkatese i cili paraqet bilancin e likujdimit Pasuria e shoqerise qe ngelet pas shlyerjes se detyrimeve te saj i kalon e gjitha ortakut te vetem

Pasuria qe eshte futur ne shoqeri me te drejta shfrytezimi i kthehet pronarit te saj .

LIBRAT E SHOQERISE

NENI 21

- 1) Libri i vendimeve te Asamblese se Pergjithshme .
- 2) Libri i Mbledhjeve .
- 3) Libri i vendimeve te administratorit
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel

Librat e mesiperme duhen te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur .

NENI 22

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin gjate egzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do te paraqiten per zgjidhje Gjykates kompetente shqiptare .

NENI 22

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje ne gjuhen shqipe duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore .

ORTAKU VETEM

